QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 8369 Prot.
Date 29.03.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

SHOQËRIA PËRMBARIMORE SPAHIU

Nr. 377, Regj., Nr. 2189/1 Prot.

Tiranë, më 28 /03/ 2022

# URDHËR
## PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

**Drejtuar** : Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

**Për dijeni**: Debitorit, Subjekti "Triangle Media Group" sh.p.k. me NIPT: L11913017I
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Kulla Nr.3, Hyrja Nr.14, Kati 11, Ap.52, Tiranë

Kreditorit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë
Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Nr.56, Tiranë

**Objekti:** Likujdim Gjobe

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k., me numër NIPT: L62204027C, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.2062, datë 27.09.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.377, kërkesën e kreditorit Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Tiranë, ndaj subjektit "Triangle Media Group" sh.p.k. në lidhje me Titullin Ekzekutiv Akti Administrativ "Vendim Gjobe" Nr.1366/2, datë 16.07.2021.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit vullnetar të detyrimit, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2079/2 Prot, date 18.11.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit,

**KONSTATOVA se :**

Debitori, subjekti "Triangle Media Group" sh.p.k. është vënë më dijeni për njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit subjektit "Triangle Media Group" sh.p.k. në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe 53 të Ligjit Nr.26/2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

**URDHËROJ**

- **Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:**

Debitori, Subjekti "Triangle Media Group" sh.p.k. me NIPT: L11913017I
Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Kulla Nr.3, Hyrja Nr.14, Kati 11, Ap.52, Tiranë.

1. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me proceduren e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:
a. Adresen e ushtrimit të aktivitetit privat.
b. Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence.
c. Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit.

2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K**

Përmbarues GJYQËSOR

**Eqerem SPAHIU**

*Adresa: Rruga Ded Gjo Luli", Pall.1, Shk.2., Kt.2., Ap.21., Tiranë, e-mail: info@spahiu.al, mob.+355682039585*